



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 14.04.2020

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7895, DATË 27.1.1995,
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”, NISMË
E DEPUTETËVE**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, (*referuar në vijim “Komisioni për Çështjet Ligjore”*) në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 14.04.2020, mori në shqyrtim projektligjin “*Për një shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*”, të ndryshuar, nismë e deputeteve Eglantina Gjermani dhe Klotilda Bushka.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relacione për shqyrtimin e projektligjit deputeten znj.Vasilika Hysi.

Të pranishëm në mbledhjen online të Komisionit ishin: znj. Mira Rakacolli, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm, z. Besmir Beja, përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë. Për të prezantuar projektligjin ishin të pranishme deputetet nismëtare Eglantina Gjermani dhe Klotilda Bushka (Ferhati). Amendamentet e propozuara në lidhje me moszbatimin e masave të autoriteteve shtetërore gjatë epidemisë ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe përhapjen e sëmundjeve infektive u prezantuan nga deputetja propozuese Edlira Bode.

Komisioni e shqyrton projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PROJEKTLIGJIT

Në Kuvendin e Shqipërisë janë depozituar dy nisma për shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Një projektligj është nismë e deputeteve Eglantina Gjermani dhe Klotilda Bushka, depozituar më 10 Janar 2020 dhe nisma tjetër është nismë

e Këshillit të Ministrave, depozituar më 6 shkurt 2020.

Projektligjet paraqiten për shqyrtim dhe miratim bazuar në nenet 78, 81 pika 1 dhe 2, shkronja "d" dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe shoqërohen me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Duke qenë se nismat synojnë shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal, ato u bashkuan dhe u shqyrtuan së bashku.

Amendamentet e propozuara nga deputetja Edlira Bode bazohen në nenin 71, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, i cili parashikon të drejtën e *cdo deputeti/e ose Këshillit të Ministrave për të propozuar amendament/te gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës. Amendamenti paraqitet me shkrim dhe i arsyetuar.*

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJEVE

2.1. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nismë e deputeteve

Sipas relacionit që shoqëron projektligjin, nisma ligjore e deputeteve Gjermani dhe Bushka synon:

- 1) pakësimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare e në njësinë shtëpiake dhe mbrojtjen e veçantë e pa diskriminim të cdo grupi që paraqet nevoja të vecanta mbrojtjeje;
- 2) përbushjen e rekomandimeve të Komitetit GREVIO për Shqipërinë, të publikuara në muajin dhjetor 2017, në cilësinë e organit që monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" (Konventa e Stambollit).

Sipas relacionit nisma ligjore sjell tre risi:

- a) kriminalizimin e dhunës psikologjike;
- b) zgjerimin e rrethit të subjekteve që mbrohen prej tij, duke parashikuar që edhe personat në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale të gëzojnë mbrojtjen e nevojshme, duke harmonizuar përmbajtjen e këtij neni me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet ligjore të bëra në vitin 2018 në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar;
- c) ashpërsimin e dënimeve penale për disa figura të kësaj vepre penale.

Nisma e deputeteve parashikon si më poshtë vijon:

"Neni 130/a

Dhuna në familje

Rrahja, si dhe cdo vepër tjetër dhune fizike, seksuale, psiko emocionale, ndaj personit që

është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim një deri në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga dy deri në 10 vjet burgim.”

2.2. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi penal Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nis më e Këshillit të Ministrave.

Nisma e Këshillit të Ministrave synon të kriminalizojë posedimin, përdorimin, mbajtjen ose ruajtjen në mënyrë të pajustificuar të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, për të cilat është vendosur konfiskimi, sipas legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar e të korrupsionit.

2.3. Amendamentet e deputetes Edlira Bode

Amendamentet e depozituara nga deputetja Edlira Bode synojnë parashikimin e dy neneve që dënojnë shkeljen e rregullave në periudhën e fatkeqësive natyrore ose të epidemive dhe përhapjen e sëmundjeve infektive, si pasojë e shkeljes së rregullave, vendimeve dhe urdhrave të nxjerra nga organet kompetente shtetërore për masat e marra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore, ose moszbatimit ose shkeljes së rregullave të karantinës dhe izolimit në periudha pandemie, epidemie ose fatkeqësie natyrore.

Konkretisht, në përmbajtjen e amendamenteve të propozuara parashikohet:

Neni 242/1

“1. Mosbindja ndaj rregullave, vendimeve dhe urdhrave të nxjerranga organet kompetente shtetërore për masat e marra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme apo gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Po kjo vepër, e kryer në mënyrë të përsëritur dënohet me burgim nga tridhjetë ditë deri në

një vit.

Kur nga vepra është shkaktuar rrezikimi i jetës ose vdekja e personit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 242/2

2. Moszbatimi i urdhrat të karantinës apo shkelja e rregullave të karantinës nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive ngjitëse, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë dhe me burgim deri në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose jetën e njerëzve dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

III. INSTRUMENTET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE SI DHE REKOMANDIMET E ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARË NË FUSHËN PËRKATËSE

3.1. Në fushën e marrëdhënieve familjare

Vepra penale e dhunës në familje (neni 130/a) është parashikuar për herë të parë në vitin 2012 me ligjin 26/2012. Dënimi me burgim varion nga dy deri në pesë vjet. Me ligjin 114/2013 kjo dispozitë pësoi ndryshime. Në vitin 2013, u parashikua si vepër penale në rrethana të cilësuar “vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” (neni 79/c) që sanksion vrasjen me dashje të personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale.

Paragrafi 2 i nenit 121/a “Përndjekja”, shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012 sanksion mbrojtjen e personit nga kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin. Në paragrafin e tretë, parashikohet mbrojtja e të miturit, gruas shtatëzanë ose një personi të pazotë për tu mbrojtur nga përndjekja.

Neni 321, paragrafi 2 i Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, shtuar paragrafi me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012, parashikon si vepër penale kryerjen e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet e lindura nga dënimet plotësuese të dhëna prej saj, si dhe në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy

vjet.

Neni 102 i kodit Penal që lidhet me marrëdhëniet seksuale me dhunë mes bashkëshortëve dhe bashkëjetuesve, etj.

Kodi penal, në pjesën e posacme parashikon disa vepra penale në marrëdhëniet familjare dhe disa institute të rëndësishme në pjesën e përgjithshme të tij. Lidhur me mbrojtjen juridike penale të fëmijëve ndryshime me rëndësi janë ato të vitit 2012 - 2013 të Kodit Penal të cilat krahas nenit 130/a dhe 121/a "Përndjekja", nenit 124/b "Keqtrajtimi i të miturit", parashikojnë dënime kryesore dhe plotësuese në rastet e dhunës ndaj fëmijës në prani të tij si neni 43/a mbi 'Humbjen e përgjegjësisë prindërore'.

Gjithashtu, neni 50 i kodit Penal parashikon si rrethanë rënduese rastet kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen si dhe rastet kur kryerja e vepres penale ndodh gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësore të mbrojtjes nga dhuna në familje. Nuk ka të dhëna zyrtare të botuara në lidhje me zbatimin e rrethanave rënduese në rastet e dhunës në familje.

Mbrojtja nga dhuna në familje është sanksionuar në disa konventa dhe instrumente ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Disa instrumente më rëndësi janë: Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 104/2012, datë 08.11.2012; Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e ratifikuar më 11 maj 1994; Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; Konventën e OKB për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventën e Kombeve të Bashkuara "Mbi të drejtat e fëmijëve" dhe protokollin e saj shtesë; Konventën e Kombeve të Bashkuara "Mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", si dhe Konventën e Këshillit të Europës "Mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".

Ratifikimi i këtyre instrumenteve ndërkombëtare dhe detyrimet e vendosura për shtetet anëtare sjellin nevojën për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm për parandalimin e dhunës në familje me standartet ndërkombëtare si dhe me rekomandimet përkatëse të organizmave monitoruese të zbatimit të tyre.

Raporti i GREVIO-s mbi zbatimin e Konventës së Stambollit në Shqipëri, i bërë publik në Dhjetor 2017, bën një vlerësim të masave legjislative dhe të politikave të ndërmarra nga shteti shqiptar gjatë viteve të fundit, për zbatimin e kërkesave të parashikuara në Konventën e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Në raport vlerësohet se Shqipëria ka miratuar një kuadër të fortë legjislativ për të trajtuar dhunën në familje në fushën e të drejtës civile dhe atë penale. Ky raport tërheq vëmendjen e ligjvënësit shqiptar te disa boshllëqe të mbetura, të cilat duhet të trajtojnë reformat legjislative në vazhdim. Këto lidhen kryesisht me mungesën e procedurave të caktuara penale që kanë në objekt dhunën psikologjike dhe sterilizimin e detyruar etj.

GREVIO ka identifikuar disa çështje prioritare që kërkojnë masa të mëtejshme nga autoritetet shqiptare për të respektuar plotësisht dispozitat e Konventës. Duke marrë

parasysh konsideratat e parashtruara në raportin e GREVIO-s, disa nga çështjet e ngritura lidhen me nevojën për të:

a) ndryshuar legjislacionin penal të Shqipërisë që e bazon veprën penale të dhunës seksuale në mungesë të dhënies së miratimit të lirë dhe ta sjellë në përputhje me standardet e Konventës lidhur me procedimin *ex parte* dhe *ex officio*;

b) rishikuar dispozitat ligjore që vlejnë për urdhrat e përjashtimit emergjent, të cilat sipas ligjit shqiptar njihen si urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje, për të garantuar që në situatat e rrezikut të menjëhershëm, urdhra të tillë të mund të lëshohen pa vonesa të panevojshme me qëllim garantimin e sigurisë së viktimës.

GREVIO ka identifikuar disa fusha shtesë ku nevojiten përmirësime me qëllim përmbushjen e plotë të detyrimeve të Konventës. Ndër të tjera, këto lidhen me përkufizimin ligjor të dhunës në familje që sipas përkufizimit të përcaktuar në nenin 3 të Konventës së Stambollit, nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve, ose ndërmjet bashkëshortëve, ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

GREVIO nxit fuqimisht autoritetet shqiptare të marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë këtu masa legjislative, për të njëtrajtësuar përkufizimin e dhunës në familje, në ligjin vendas, me atë të Konventës, si dhe për të siguruar zbatimin efektiv në praktikë të këtij përkufizimi të njëtrajtësuar.

Neni 33 i Konventës kërkon që palët të kriminalizojnë dhunën psikologjike, e cila përshkruhet si sjellje me dashje për të dëmtuar rëndë integritetin psikologjik të një personi me anë të shtrëngimit ose kërcënimeve. Në këtë drejtim, abuzimi psikologjik konsiderohet të jetë i përhapur si formë e dhunës në familje e cila mund të perceptohet nga viktimat si më e rëndë dhe më e dëmshme sesa dhuna fizike. Dhuna psikologjike shikohet gjithashtu si një pararendës i shpeshtë i dhunës fizike dhe e lidhur me dhunën ekonomike siç është privimi ose kufizimi i burimeve financiare.

Në këtë aspekt, në raportin e GREVIO-s parashtrohen disa rekomandime lidhur me ligjin penal shqiptar:

33. *GREVIO nxit autoritetet shqiptare të korrigjojnë mangësitë në legjislacionin penal që lidhen me dhunën psikologjike (paragrafi 127).*

Justifikimet e papranueshme për krime, duke përfshirë krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit “nder” (neni 42)

39. *GREVIO nxit fuqimisht autoritetet të harmonizojnë dispozitat përkatëse të Kodit Penal Shqiptar me dispozitat e nenit 42 të Konventës. Më konkretisht, rrethanat e parashikuara në nenin 48, shkronjat (a) dhe (b) të Kodit, që kanë të bëjnë, nga njëra anë, me “motivët e vlerave morale dhe sociale pozitive” dhe nga ana tjetër, me “tronditjen psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprimet e padrejta të viktimës apo një personi tjetër” nuk duhet të konsiderohen si rrethana lehtësuese në rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave (paragrafi 159).*

41 *GREVIO nxit autoritetet të plotësojnë boshllëqet e vogla të mbetura në ligjin penal, në*

lidhje me rrethanat rënduese (paragrafi 169).

45. GREVIO u kërkon autoriteteve: e. të ndjekin penalisht dhunuesit që shkelin urdhrat e mbrojtjes së menjëhershme dhe urdhrat e mbrojtjes, si dhe të zbatojnë dënimet penale përkatëse;

48. GREVIO u kërkon autoriteteve të ndryshojnë legjislacionin e tyre për ta sjellë në pajtim rregullat e ndjekjes penale ex parte dhe ex officio, të përcaktuara në nenin 55, paragrafi 1 i Konventës (paragrafi 198).

3.2. Në fushën e parandalimit dhe luftimit të infeksioneve dhe sëmundjeve infektive

Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" përcakton përgjegjësitë dhe rolin e shërbimeve shëndetësore, shërbimeve të shëndetit publik, si dhe aktorëve të tjerë të të gjitha niveleve, publike e jopublike, në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësive për sëmundjet infektive dhe ngjarjet me rëndësi për shëndetin publik.

Neni 35 i ligjit parashikon sanksionet administrative të shkeljeve që nuk përbëjnë vepra penale. Në lidhje me këtë ligj, Kodi Penal në fuqi nuk parashikon vepra penale që lidhen me përhapjen e sëmundjeve infektive me rrezikshmëri shoqërore të lartë, ose në rast të fatkeqësive natyrore apo të epidemive. Miratimi i ligji nr. 15/2016 duhet të shoqërohej edhe me ndryshime në Kodin Penal dhe të plotësonte vakumin ligjor që ekzistonte kohë më parë.

Vende të ndryshme evropiane parashikojnë në legjislacionin e tyre penal vepra penale në lidhje me përhapjen e epidemive dhe/ose shkeljen e të karantinës. Kodi Penal i Danimarkës, Kroacisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Hungarisë, Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Maltës dhe Italisë parashikojnë si vepra penale veprimet dhe mosveprimet që rrezikojnë personat dhe kafshët nga sëmundjet infektive. Disa prej këtyre kodeve parashikojnë përhapjen e sëmundjeve infektive me dashje ose për shkak të neglizhencës (Danimarka, Kroacia); disa kode parashikojnë se për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, ndjekja penale mund të bëhet me ankim të të dëmtuarit (Kroacia). Në varësi të formës së fajësisë dhe pasojave të ardhura, të gjitha kodet penale të analizuara parashikojnë dënime penale me burgim në mënyrë proporcionale.

IV. LIDHJA E PROJEKTLIGJIT ME OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal, konkretisht në nenin 130/a të tij synon realizimin e disa prej Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, përkatësisht: objektivi 5 "Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjithë grave dhe vajzave" dhe objektivi 16 "Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse

në të gjitha nivelet".

Amendamentet në lidhje me parandalimin e shpërndarjes së sëmundjeve infektive synojnë realizimin e disa prej Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, përkatësisht: objektivi 3 "Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe mirëqënies së njerëzve të të gjitha moshave" dhe objektivi 16 "Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet".

V. KONSULTIMI PUBLIK I NISMAVE

Bazuar në përvojën, tashmë të konsoliduar, për konsultimin publik të projektligjeve të zhvilluar nga Komisioni për Çështjet Ligjore, pas depozitimit dhe përfshirjes së projektligjit në programin e punës së Kuvendit dhe në kalendarin e punës së Komisionit, nisma e deputeteve Klotilda Bushka dhe Eglantina Gjermani së bashku me amendamentet e propozuara nga deputetja Edlira Bode iu përcoll për mendim institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në këtë fushë.

Nisma për shtesa dhe ndryshime në nenin 130/a "Dhuna në familje" i është nënshtruar dy herë konsultimit publik, gjatë muajit Shkurt dhe Prill 2020, ndërsa nisma e Këshillit të Ministrave dhe e deputetes Bode gjatë muajit Prill 2020.

U ftuan 12 organe dhe institucione të pavarura të kontribuojnë e të japin ekspertizën e tyre profesionale në fushën e legjislacionit penal dhe çështjeve të trajtuara me ndryshimet e propozuara në Kodin Penal, konkretisht: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Avokati i Popullit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma e Avokatëve Penalistë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Urdhri i Mjekëve.

Komisioni i është drejtuar për mendim: Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Departamentit të Drejtësisë pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë (OPDAT), Misionit të Asistencës Evropiane për Shqipërinë, projektit "EURALIUS V" dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Nisma dhe amendamentet u janë dërguar për mendim 4 organizatave vendase të angazhuara në fushën e të drejtave të njeriut ose që janë të angazhuara në fushat që trajton nisma, konkretisht: Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqatës së Avokatëve Penalistë, Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe 23 universiteteve publike dhe jopublike të vendit si dhe me Akademinë e Shkencave, Komisioni iu drejtua për mendim 3 fakulteteve të Universitetit të Tiranës: Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Shkencave Sociale.

I janë përgjigjur kërkesës për mendim të Komisionit për Çështjet Ligjore lidhur me nismën

ligjore 14 institucione dhe organizata, gjyqtarë, profesorë dhe 31 studentë që ndjekin studimet në programin e studimeve master shkencor penal në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Bazuar në thirrjen publike për të shprehur mendime për këto nisma, kanë depozituar mendime edhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

Kanë paraqitur me shkrim opinionet dhe sugjerimet e tyre lidhur me nismën: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Misioni i asistencës Evropiane për Shqipërinë, projekti "EURALIUS V", Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, UNDP Albania, Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra Kombetare për Sherbime Komunitare, gjyqtari pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Laurent Fuçia, lektorë dhe asistent lektorë në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës, Dr. Etlon Peppo, Msc. Etien Isak, si dhe anëtarë të komisionit të Ligjeve.

32 organizata të shoqërisë civile në një deklaratë për mediat kanë shprehur mendimin e tyre lidhur me amendamentet e deputetes Edlira Bode. Opinioni i tyre është trajtuar në procesin e konsultimit publik.

Në mënyrë të përmbledhur disa nga sugjerimet e ardhura në adresë të komisionit janë si më poshtë më vijon:

Prokuroria e Përgjithshme paraqet komente për nismat e deputeteve. Lidhur me ndryshimin e nenit 130/a të Kodit Penal. Prokuroria e Përgjithshme vë në pah nevojën e dallimit mes përmbajtjes së nenit të sugjeruar dhe dispozitave që ka Kodi Penal në lidhje me dhunën seksuale dhe se ashpërsimi i dënimeve sugjerohet të paraprihet nga studime të ndikimit të politikës penale aktuale.

Sugjerimi i Prokurorisë së Përgjithshme u mbajt parasysh në riformulimin e dispozitës. Ndërkohë, iu kërkua përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë botimi dhe përpunimi i të dhënave të detajuara për veprat penale për shkak të marrëdhënie familjare, dënimet dhe zbatimet e tyre në raport me viktimat dhe veçoritë e tyre si dhe një studim të ndikimit të ndryshimeve të mëpërshme në Kodin Penal.

Lidhur me amendamentet e propozuara nga deputetja Bode, është sugjeruar: riformulimi i dispozitave të propozuara në përfaqje me teknikën legjislative të unifikuar në nenet shtesë që përgjithësisht i janë bërë Kodit Penal; riformulimi i rrethanave cilësuese që lidhen me pasojën; qartësim të anës subjektive të dispozitave, dashjen e veprimeve dhe mosveprimeve në shkelje të masave të përcaktuara në aktet normative të ligjshme; rishikim të masave të dënimeve të propozuara në varësi të pasojës dhe formës së anës subjektive që është dashja në kryerjen e veprave penale, mos aplikimi i dy dënimeve kryesore për të njëjtën vepër penale, pra gjoba dhe dënimi me burgim.

Këto sugjerime janë mbajtur parasysh në riformulimin e dispozitave të depozituara.

Këshilli i Lartë Gjyqësor sugjeron rishikimin e dënimeve të propozuara në nismën e deputeteve për ndryshime të nenit 130/a të Kodit Penal. Lidhur me dispozitat ligjore të propozuara nga deputetja Bode sugjerohet: riformulimi me qëllim qartësimin e tyre në

përputhje me parimin e ligjshmërisë të së drejtës penale dhe parimin e sigurisë juridike; rishikimi i llojit të dënimeve të parashikuara që të jenë proporcionale.

Të dy sugjerimet e KLGJ-së janë mbajtur parasysht gjatë riformulimit të dispozitës.

Unioni i Gjiqtarëve të Shqipërisë shprehet se propozimet për ndryshimet në Kodin Penal lidhur me dhunën në familje dhe veprat e reja penale janë shumë të ashpra. Unioni vlerëson përfshirjen e subjektit pasiv “*person ne lidhje apo ish-lidhje intime*” me autorin e veprës. Lidhur me nismën e deputetes Bode, vihet në dukje nevoja për referimin e ligjeve që mund të shkelen gjatë periudhës së fatkeqësisë natyre dhe epidemive, diferenca e madhe në minimum dhe maksimum të masës së dënimit, dallimi i përgjegjësisë penale në varësi të formës së fajësisë.

Në riformulimin e dispozitave, sugjerimet e mësipërme janë mbajtur parasysht.

Ministria e Drejtësisë, lidhur me nismën për nenin 130/a sugjeron që terminologjia e subjekteve të posaçme të veprës penale të dhunës në familje të përshtaten me përcaktimin që bën Konventa e Stambollit. Ky sugjerim është mbajtur parasysht gjatë riformulimit të dispozitës.

Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale lidhur me nismën ligjore të propozuar nga deputetet Eglantina Gjermani dhe Klotilda Bushka për ndryshim të nenit 130/a të Kodit Penal ka shprehur dakortësinë. Sipas ministrisë këto ndryshime janë në përputhje me rekomandimet e GREVIOS dhe CEDAË. Lidhur me amendimet e deputetes Bode, ministria shprehet parimisht dakord, por sugjeron që në paragrafin e parë të nenit 242/2 të mos i referohemi vetëm karantinës, por edhe izolimit dhe vetëkarantinimit. Ky sugjerim është zbatuar.

Avokati i Popullit sugjeron lidhur me nenin 130/a “Dhuna në familje: saktësimin e termave “*krushqi e afërt*” apo “*lidhje intime*”. Duke vlerësuar përcaktimin e dënimit minimal në dispozitën e propozuar, Avokati i Popullit sugjeron rishikimin e dënimeve të propozuara dhe të jenë proporcionale.

Lidhur me nenin 242/2 “Shkelja e rregullave të karantinës për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive”, Avokati i Popullit sugjeron: në paragrafin e parë të kësaj dispozite të hiqen fjalët “ose jo” pas fjalëve “personi mbartës”; të rishikohen dënimet e propozuara, duke ulur ashpërsinë e tyre dhe shmangien e aplikimit të dy dënimeve; heqjen e paragrafit të tretë si të panevojshëm, sepse në thelb ai është i përfshirë në paragrafin e dytë dhe nuk duhet të jetë më vete.

Sugjerimet e Avokatit të Popullit kanë gjetur zbatim pjesërisht në ndryshimet e miratuara në Komision. Sugjerimet e tjera iu përcollën Ministrisë së Drejtësisë për t’u mbajtur në konsideratë nga grupi i ekspertëve që po punon për një Kod të ri Penal.

Misioni EURALIUS rekomandon rishikimin e përfshirjes së kategorisë së “personave në lidhje intime” në listën e subjekteve të nenit 130/a të Kodit Penal. Ky sugjerim nuk është marrë në konsideratë, por është zbatuar rekomandimi i GREVIO-s për Shqipërinë. Lidhur me rekomandimin e deputetes Bode, EURALIUS sugjeron: mos ndëshimin dyfish me sanksione penale dhe administrative, duke sugjeruar të shtohet togfjalëshi ‘kur nuk është ndëshkuar administrativisht’; riformulimin e nenit 242/2 duke rekomanduar modelet

e dispozitave të parashikuara në Kodin Penal Italian dhe Austriak. Ky sugjerim është zbatuar.

Ekspertet e **UNDP Albania** kanë shprehur sugjerimin në lidhje me propozimin për dhunën në familje. Sipas tyre, ndryshimet e propozuara të shtrihen edhe tek dhuna e ushtruar ndaj personit në kujdestari. UNDP Albania sugjeron: të saktësohet kuptimi i kategorisë “gjini e afërt” dhe “krushqi e afërt”; të rishikohen disa nga dispozitat ligjore materiale e proceduriale në fuqi lidhur me trashëgiminë dhe padenjësinë për të trashëguar të agresorit/dhunuesit; të hiqet shprehja “parashikohet dënim me vdekje” pasi në nenin 322 të Kodit Civil, sepse ky dënim nuk ekziston në legjislacionin shqiptar. Propozimet e eksperteve janë zbatuar pjesërisht. Sugjerimet e tyre iu përcollën Ministrisë së Drejtësisë për t’i mbajtur në konsideratë nga grupi i ekspertëve që po punon për një Kod të ri Penal.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit në opinionin e shprehur lidhur me amendamentet e deputetes Bode parashtron se në dispozitat e propozuara nuk bëhet dallimi midis veprës së kryer me dashje dhe asaj të kryer nga pakujdesia dhe dënimet janë të ashpra dhe joproporcionale me vepra të ngjashme parashikuar në Kodin Penal. Këto shqetësime u mbajtën në vëmendje gjatë ndryshimeve të miratuara në Komision.

Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare sugjeron rishikimin e përfshirjes së dhunës psiko-emocionale në nenin 1 të projektligjit që ndryshon nenin 130/a të Kodit Penal, vecanërisht në lidhje me parashikimin e dënimit deri në 10 vjet burgim, kur kjo vepër kryhet në mënyrë të përsëritur, ose në prani të fëmijëve. Ky sugjerim është zbatuar.

Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë sugjeron riformulime të neneve 242/1 dhe 242/2 të amendamenteve të propozuara nga deputetja Edlira Bode me qëllim saktësimin e subjektit të veprës penale dhe ardhjes së pasojës së rëndë; ulje të dënimeve të propozuara si jo proporcionale me dënimet që parashikojnë vepra të të njëjtit lloj në Kodin Penal. Sugjerimet janë zbatuar.

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) sugjeron në lidhje me dispozitat e amendamentet e propozuara nga deputetja Bode që cdo veprim dhe mosveprim duhet parashikuar nëpërmjet një rregullimi të posacëm për: a) subjektin i cili nuk është mbartës i infeksionit, por shkel kufizimet e përcaktuara në rregullat, vendimet dhe urdhrat e organeve publike, pasi është dhënë më parë masë administrative; b) subjektin i cili është në izolim ose karantinë dhe shkel legjislacionin parandalues në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore ose gjendjes së jashtëzakonshme; c) rastet kur nga vepra ka ardhur dëmtimi i shëndetit të një ose disa personave; d) rastet kur nga vepra ka ardhur vdekja e një ose më shumë personave.

Fondacioni i sugjeron Komisionit parashikimin e sanksioneve penale në seksionin e veprave penale kundër shëndetit, në rastet kur personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive nëpërmjet kryerjes së veprimeve apo mosveprimeve të kryera me dashje ose si pasojë e shkeljes së urdhrat të izolimit përhap sëmundje infektive që mund të shkaktojë epidemi tek personeli mjekësor ose/dhe tek njerëzit. Sugjerohet gjithashtu, rishikimi i masës së dënimeve me burgim të propozuar si dhe të marzheve të dënimit minimum dhe maksimum

të tyre për të qenë sa më të drejta dhe propocionale gjithashtu dhe me kategoritë e tjera të veprave penale të parashikuara në Kodin Penal si dhe mosaplikimi i dy dënimeve kryesore për të njëjtën vepër penale, pra gjoba dhe dënimi me burgim. Gjatë riformulimit të dispozitave sugjerimet janë mbajtur parasysh.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson ashpërsimin e dënimit për rastet e dhunës në familje. Në lidhje me nismës e deputetes Bode vlerëson nevojën e një dispozite të re, dhe sugjeron: shyrtimin jo me procedure të përshpejtuar, qartësimin e dispozitës 242/2 duke konsideruar dallimin midis subjekteve mbartës ose jo mbartës të sëmundjes infektive ngjitëse; zbutjen e masave të dënimit dhe moszbatimin e dy dënimeve kryesore.

Sugjerimet e KMD-së janë mbajtur parasysh gjatë riformulimit të dispozitave. Lidhur me argumentin e procedurës së ndjekur, qëndrimi është shprehur më lart.

Në një deklaratë të përbashkët për median, një grup organizatash të shoqërisë civile duke vlerësuar në tërësi masat e marra nga qeveria për parandalimin dhe luftën ndaj pandemisë globale Covid19 në vendin tonë, kanë ngritur disa shqetësime lidhur me amendamentet e deputetes Edlira Bode, konkretisht: dënime joproportionale, shqyrtimi i nismës me procedurë të përshpejtuar, mosbërja dallim sa i takon subjektit që kryen këto vepra nëse është mbartës ose jo i sëmundjes infektive; parashikimi i dënimeve të ashpra dhe dy dënimeve kryesore, dënimin me gjobë dhe dënimin me burgim. Pjesa më e madhe e shqetësime të tyre janë adresuar. Lidhur me argumentin e procedurës së ndjekur, qëndrimi është shprehur më lart.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personal u shpreh se nismat e paraqitura për konsultim publik nuk përmbanin çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së tij.

Prezenca e OSBE shprehet për nismat e deputeteve duke sugjeruar që ndryshimet në Kodin Penal të bëhen përmes një procedure jo të përshpejtuar. Sipas OSBE, pavarësisht përpjekjes nga ana e Parlamentit për të mbledhur opinione ligjore dhe rekomandime online, koha ka qënë e shkurtër.

Lidhur me sa më sipër, procedura e shqyrtimit të ndryshimeve në Kodin Penal nuk është e përshpejtuar dhe megjithë vijimësinë e punës online nga Kuvendii Shqipërisë, procesi i konsultimit publik ka funksionuar dhe produkti i konsultimit në mënyrë të përmbledhur është paraqitur në raport.

Gjyqtari Laurent Fucia në lidhje me nismën e deputetes Bode, argumenton se mjafton vetëm neni 241/1 dhe nevoja për të hartuar dispozita të qarta, të përmbledhura dhe sa më koncize në parashikimet e tyre, paragrafët cilësues duhet të shmangen si dhe moszbatimi i dy dënimeve kryesore.

Dy sugjerime janë mbajtur parasysh në riformulimin që u është bërë dispozitave të propozuara, ndërsa sugjerimet për të mos parashikuar rrethana cilësuese pjesërisht duke bërë një riformulim të këtyre paragrafëve.

Pedagogu Elton Peppo në Fakultetin e Drejtësisë, UT, lidhur me nismën për dhunën në familje sugjeron riformulim të dispozitave në përputhje me terminologjinë ligjore dhe përkufizimin e veprës penale të dhunës në familje rigorozisht sipas Konventës së Stambollit si dhe ndryshime të teknikës legjislative. Sugjerimet u morën në konsideratë

pjesërisht nga komisioni. Sugjerimi për përfshirjen e dhunës seksuale në dispozitën e dhunës në familje iu përcoll Ministrisë së Drejtësisë për ta mbajtur në konsideratë nga grupi i ekspertëve që po punon për një Kod të ri Penal.

z. Msc.Etien Isak, pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, UT sugjeron që hapat e procesit ligjvënës për dispozitat 242/1 dhe 242/2 duhet të ishin ndjekur në mënyrë të mëvetësishme nga projektligji për ndryshimin e nenit 130/a “Dhuna në familje” i depozituar që në dt.10.01.2020. Sikurse është argumentuar edhe më lart, cdo deputet/e ka të drejtë të paraqesë amendamente në një nismë që është në shqyrtim në procedurë parlamentare.

VI. DISKUTIME NË KOMISION

Nisma ligjore për ndryshime në dispozitën e Kodit Penal për dhunën në familje u prezantua nga deputetet nismëtare Eglantina Gjermeni dhe Klotilda Bushka. Deputetet argumentuan nevojën për të ndryshuar dhe plotësuar dispozitën ligjore për dhunën në familje në Kodin Penal duke parashtruar katër komponentët kryesore të propozimeve të tyre që konsistojnë në:

- a) përfshirjen e dhunës psikologjike në përmbushje të rekomandimeve të Komitetit GREVIO për Shqipërinë, të publikuar në dhjetor 2017;
- b) përfshirjen e dhunës seksuale, propozim i cili buron nga rekomandimi i raportit GREVIO dhe mbështetet nga organizatat e shoqërisë civile, por sikurse është vlerësuar nga Prokuroria e Përgjithshme konvergjon në raport me parashikimet e nenit 102 të K.Penal *“Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”*;
- c) përfshirjen si subjekt të veprës penale të *“partnerit apo ish partnerit që ka qënë në lidhje intime me viktimën”*; propozim i cili vjen në harmoni me ndryshimet që iu bënë në vitin 2018, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, të ndryshuar, ku është dhënë për herë të parë dhe definicioni për këtë subjekt si dhe në përputhje me parashikimet e Konventës së Stambollit, neni 3 (b) dhe raporti shpjegues, paragrafet 41 dhe 42 të cilat përcaktojnë si dhunë në familje dhe veprat e dhunës të kryera nga personat në lidhje intime, me cilësinë e partnerit apo ish partnerit pavarësisht gjendjes së përbashkët të banimit me viktimën e dhunës.; ç) rritjen e masave të dënimit me qëllim parandalimin e rasteve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

Pas prezantimit të nismës, deputetja Edlira Bode prezantoi amendamentet e propozuara prej saj për shtimin e dy dispozitave të reja në Kodin Penal lidhur me mosbindjen ndaj masave të organeve kompetente shtetërore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe shkeljes së rregullave të karantinës për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive. Znj. Bode parashtroi arsyet e saj lidhur me propozimin e amendamenteve si dhe modelet e vendeve të tjera të marra si referencë në propozimet e bëra. Në përgjigje të komenteve të bëra së fundmi në deklaratat mediatike lidhur me shkeljen e të drejtat të njeriut, znj. Bode argumentoi se e drejta e shëndetit dhe e jetës janë të drejta që prevalojnë mbi cdo të drejtë tjetër dhe qëllimi i propozimeve të amendamenteve të saj janë pikërisht mbrojtja e këtyre të drejtave për të gjithë popullatën. Në fund të fjalës së saj, znj. Bode ftoi anëtarët e komisionit që si ekspertë në fushën e ligjeve të bëjnë

riformulimet e nevojshme të amendamenteve të paraqitura dhe t'i miratojnë ato.

Relatorja e caktuar nga komisioni për shqyrtimin e projektligjit, znj. Vasilika Hysi, informoi anëtarët e komisionit mbi procedurën e ndjekur nga komisioni për konsultimin publik të projektligjeve dhe amendamenteve të paraqitura me institucionet dhe organizatat që iu përgjigjën ftesës së komisionit dhe dhanë kontributin e tyre me mendime dhe sugjerime të vlefshme. Ajo bëri me dije sugjerimet e adresuara dhe vlerësimin e tyre në procesin e riformulimit të dispozitave.

Relatorja vlerësoi dhe falenderoi të gjithë përfaqësuesit e institucioneve, të organeve të pavaruara kushtetuese ose të krijuara me ligj, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare që vepronë në Shqipëri, pedagogë dhe studentë për përfshirjen e tyre në procesin e konsultimit publik të nismave, por edhe për mendimet dhe sugjerimet e shprehura.

Relatorja falenderoi deputetet nismëtare për propozimet e nevojshme për ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal në lidhje me dhunën në familje, por nga ana tjetër ajo theksoi se këto ndryshime janë të pjesshme. Relatorja vuri theksin në nevojën e përmbushjes së të gjithë rekomandimeve të Komitetit Grevio për Shqipërinë për të cilat është e nevojshme të ndërhyhet si në pjesën e përgjithshme, ashtu edhe në pjesën e posacme të Kodit Penal.

Ajo theksoi nevojën për një Kod të ri Penal dhe kërkoi nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë që të punojnë në këtë drejtim për të adresuar jo vetëm rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë, por të parashikohen të gjitha format e reja të kriminalitetit dhe të sigurohet një mbrojtje më e mirë e grave dhe vajzave si dhe të rivendosen balancat shpesh të dëmtuara mes krerëve dhe seksioneve të Kodit Penal.

Nisma e deputetes Edlira Bode për të parashikuar si vepër penale përhapjen e sëmundjeve infektive me rrezikshmëri të lartë shoqërore është e mirëpritur në kushtet e një vakumi ligjor që ka Kodi Penal.

Shqyrtimi i nismës u shoqërua me diskutime nga anëtarët e komisionit. Z. Korab Lita ngriti shqetësimin e tij lidhur me amendamentet e deputetes Bode dhe u shpreh se ishte kundër miratimit të tyre duke argumentuar se procedura e ndjekur për shqyrtimin e tyre është e pershpejtuar e gjithashtu lloji dhe përmasat e dënimit që parashikohen janë disproporcionale me rrezikshmërinë që sjellin ato. Lidhur me procedurën dhe mekanizmin e gjetur nëpërmjet Rregullores së Kuvendit për të shqyrtuar shpejt amendamentet e propozuara, u shpreh kundër edhe anëtarë të tjerë të opozitës: z. Andi Përmeti, z. Alban Zeneli dhe z. Ralf Gjoni.

Z. Xhafaj në diskutimin e tij theksoi se për ndërhyrje në ligje të tilla si Kodi Penal, qofshin këto të propozuara nga qeveria apo nga deputetë, është e nevojshme një analizë e thelluar faktesh e statistikash e mbi të gjitha të jenë produkt i një konsultimi të gjerë me grupet e interesit, me profesionistët e fushës dhe organizatat e shoqërisë civile. Ai vlerësoi procedurën e ndjekur nga kryetari i komisionit dhe relatorja për konsultimin publik të projektligjit si dhe interesin e gjerë për t'u përfshirë në këtë proces konsultimi si dhe

interesin e treguar për vetë procesin ligjvënës.

Z. Xhafaj u shpreh se, mungesa e dispozitave specifike në legjislacionin tonë penal e bëjnë të rëndësishëm shqyrtimin e amendamenteve të paraqitura nga deputetja Bode lidhur me ndëshkimet penale në situatat e pandemisë. Është e nevojshme, shtoi z. Xhafaj që krahas masave administrative, të parashikohen edhe masa penale në funksion të një sigurie të lartë. Duke vlerësuar përpjekjet e znj. Bode si ligjvënëse, mjeke dhe qytetare, ai mbështeti riformulimin e paraqitur nga relatorja duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë e dispozitës penale në kohë, raportin midis masave administrative dhe penale, llojin e dënimeve dhe vecanërisht masat e tyre.

Lidhur me dispozitën për dhunën në familje, z. Xhafaj kërkoi rishikimin e masave të dënimit, të cilat në konsideratën e tij janë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, parimin e ligjshmërisë dhe cdo parim tjetër të së drejtës.

VII. NDRYSHIME TË MIRATUARA NË KOMISION

Bazuar në konsultimin e gjerë publik dhe diskutimet e propozimet e anëtarëve të komisionit, u bënë vlerësimet e mëposhtme:

Së pari, nisma e Këshillit të Ministrave në lidhje me kriminalizimin e posedimit përdorimit, mbajtjes ose ruajtjes në mënyrë të pajustificuar të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, për të cilat është vendosur konfiskimi, sipas legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar e të korrupsionit, u vendos që të mos shqyrtohet në këtë fazë dhe të vlerësohet së bashku me nismat e tjera pas hyrjes në fuqi të aktit normativ me fuqinë e ligjit dhe nevojën e vlerësimit të saj në lidhje me dobishmërinë.

Së dyti, nisma e deputeteve në lidhje me ndryshimet në nenin 130/a të Kodit Penal u sugjerua të riformulohet, bazuar në sugjerimet e bëra gjatë konsultimit publik dhe diskutimet në komision.

Së treti, amendamentet e deputetes Bode u vlerësuan dhe u sugjerua të riformulohen bazuar në diskutimet e deputetëve dhe mendimet dhe opinionet e shprehura gjatë konsultimit publik.

Në cilësinë e komisionit përgjegjës, Komisioni për Çështjet Ligjore, vlerëson nismën dhe amendamentet e propozuara në aspektin procedural dhe material, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në standardet ndërkombëtare dhe kombëtare, në legjislacionin specifik në këtë fushë, në praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe në modelet e praktikave të vendeve të BE-së. Në analizën e ndryshimeve u mbajt parasysh se ndërhyrjet në Kodin Penal duhet të jenë të kujdesshme dhe të qëndrueshme. Në analizën e shtesave dhe ndryshimeve, Komisioni u bazua në parimet kushtetuese dhe ato mbi të cilat është hartuar dhe zbatohet Kodi Penal.

Në shqyrtimin e amendamenteve Komisioni për Çështjet Ligjore mbajti parasysh edhe Dokumentin Informativ të Këshillit të Evropës SG/Inf (2020)11 7 Prill 2020¹, që adreson informacione për vendet anëtare. Në këtë dokument vihet theksi te respektimi i të drejtave të njeriut ndërsa merren masa për të parandaluar përhapjen e infeksionit COVID19. Ndër të tjera në raport vihet theksi në nevojën e respektimit të nenit 5 të KEDNj që në paragrafin 5.1 parashikon se *parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse është një prej arsyeve, për të cilat një person mund të privohet nga liria e tij*. KE nënvizion se para marrjes së kësaj mase, shtetet të kontrollojnë nëse ekziston një bazë ligjore e përshtatshme dhe të shqyrtojnë nëse masat që çojnë në privimin e lirisë janë rreptësisht të nevojshme në raport me masa alternative të tjera më pak shtrënguese”.

Në vlerësimin e amendamenteve u mbajtën parasysh edhe udhëzimet e CPT në lidhje me të drejtat e personave të privuar nga liria në kushtet e Covid 19²

Në lidhje me amendamentet në diskutim kanë shprehur opionione dhe kontribute konkrete deputetët Ulsi Manja, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Elena Xhina, Adnor Shameti, Ermonela Felaj dhe Ilir Beqaj.

Lidhur me riformulimet e nenit 130/a të Kodit Penal

Pas diskutimeve në komision dhe bazuar në konsultimin publik të nismës u miratua riformulimi për nenin 130/a, si më poshtë vijon:

Neni 130/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 130/a

Dhuna në familje

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëlla, motër, ungj, emtë, nip, mbesë, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, dhëndër, nuse, kunat, kunatë, thjeshtë, njeri e njerke), ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues ose ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëlla, motër, ungj, emtë, nip, mbesë, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, dhëndër, nuse, kunat, kunatë, thjeshtë, njeri e njerke), ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet.

¹ Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19 “Paketë për shtetet anëtare”

² <https://rm.coe.int/16809d569f>

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues ose ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëlla, motër, ungj, emtë, nip, mbesë, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, dhëndër, nuse, kunat, kunatë, thjeshtër, njerë e njerë), ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim.”

Argumentet për riformulimet e mësipërme janë si më poshtë vijon:

a) Në lidhje me përfshirjen e dhunës psikologjike, përfshirja e dhunës psikologjike përmbush një nga rekomandimet e Komitetit GREVIO³ për Shqipërinë, të publikuar në Dhjetor 2017 dhe për këtë arsye çmohet e nevojshme të pranohet kjo pjesë e amendamenteve të propozuara në Kodin Penal.

Në këtë raport, shprehimisht thuhet:

“123. Neni 33 i Konventës kërkon që palët të kriminalizojnë dhunën psikologjike, e cila përshkruhet si sjellje me dashje për të dëmtuar rëndë integritetin psikologjik të një personi me anë të shtrëngimit ose kërcënimeve. Në këtë drejtim, abuzimi psikologjik konsiderohet si një formë mbizotëruese e dhunës në familje, e cila mund të perceptohet nga viktimat si më e rëndë dhe më e dëmshme se dhuna fizike. Gjithashtu, ajo shihet shpesh si një pararendës i dhunës fizike dhe e lidhur me dhunën ekonomike, të si privimi ose kufizimi i burimeve financiare.

124. Të dhënat e disponueshme tregojnë se dhuna psikologjike, të paktën brenda njësisë familjare, është forma më e përhapur e dhunës ndaj grave në Shqipëri. Anketimi i vitit 2013 për dhunën në familje, i kryer nga INSTAT, nxjerr në pah se një shumicë prej 58.2% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë psikologjike në martesat e tyre/marrëdhëniet intime, ndërsa 52.8% e grave ishin “aktualisht” duke përjetuar dhunë psikologjike (deri në 12 muajve para intervistës). Thënë ndryshe, më shumë se 1 në 2 gra keqtrajtoheshin psikologjikisht në marrëdhëniet e tyre martesore/intime në kohën e anketimit.

125. Dhuna psikologjike, sipas përkufizimit të nenit 33 të Konventës, nuk gjen shprehje në KPSH. Format e dhunës psikologjike mund të ndiqen penalisht në rastet e dhunës në familje, ku përfshihen të gjitha aktet e dhunës, përfshirë kërcënimet për vdekje ose lëndime të tjera të rënda që pasojnë në shkëlqje të integritetit psikik e social të viktimës.”

b) Në lidhje me përfshirjen e dhunës seksuale. Në lidhje me propozimin e sugjeruar për përfshirjen edhe të rasteve të dhunës seksuale në nenin 130/a, dhe pse mbështetet nga

3

GREVIO – Grupi i Pavarur i Ekspertëve për monitorimin dhe zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit e Këshillit të Europës).

organizatat e shoqërisë civile⁴, çmohet se qëndron shqetësimi i ngritur nga Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me parashikimet e nenit 102 të K.Penal dhe në mënyrë që të mos konvergojë me propozimin e nismëtareve, këto të fundit mund të bien dakort ta tërheqin këtë pjesë të propozimit, nëse anëtarët e Komisionit nuk shprehen dakort për këtë pjesë të propozimit. Nismëtarët çmojnë të vënë në dijeni anëtarët e Komisionit se përfshirja e dhunës seksuale në këtë nen ka buruar dhe nga rekomandimi i raportit GREVIO ku thuhet shprehimisht:

“196. Dhuna në familje nuk përfshihet në nenin 284 të K.Pr.Penale-së, andaj është objekt i ndjekjes penale. Kjo do të thotë se çdo rast dhune fizike, përfshirë plagosjen e lehtë me dashje dhe rrahjen, kurdoherë që kryhet në sferën e marrëdhënieve familjare, ndiqet ex officio penalisht. Neni 130/a i KPSH-së që përkufizon dhunën në familje nuk përfshin dhunën seksuale; kjo do të thotë se këto raste dhune mund të hetohen dhe ndiqen vetëm nëse viktimat bënë ankim ose kallëzim. Duke marrë parasysh tabutë rreth dhunës seksuale, nëse kjo formë e dhunës do të ishte objekt i ndjekjes publike, kjo mund të shërbente për ta bërë këtë fenomen të dalë në dritë nga kallëzimet aktuale.

197. Në bazë të analizës më sipër, ligji shqiptar, i cili e vendos dhunën fizike që nuk cilësohet si dhunë në familje, dhunën seksuale nëse cilësohet apo jo si dhunë në familje dhe martesën e detyruar si objekt i hetimit dhe ndjekjes penale ex parte, nuk është në përputhje me kërkesat e dhëna në nenin 55 të Konventës. Që të presësh që viktimat e këtyre formave të dhunës të çelin procedurat e ndjekjes private kundër dhunuesve, do të thotë të injorosh hezitimin e tyre për të kallëzuar duke rritur rrezikun e viktimizimit për së dyti ose dhunës së mëtejshme”.

Më tej në raportin e vitit 2017, GREVIO u kërkon autoriteteve shqiptare të ndryshojnë legjislacionin e tyre në mënyrë që ta sjellin atë në përputhje me rregullat e ndjekjes penale ex parte dhe ex officio, të përcaktuara në nenin 55, paragrafi 1 i Konventës⁵.

c) Në lidhje me përfshirjen si subjekt të veprës penale të “partnerit apo ish partnerit që ka qënë në lidhje intime me viktimën”. Në lidhje me shqetësimet e ngritura nga anëtarët të Komisionit të Cështjeve Ligjore, mbi propozimin për të shtuar në nenin 130/a të Kodit Penal si subjekt të veprës penale dhe “partnerin apo ish partnerin që ka qënë në lidhje intime me viktimën”, kjo shtesë është e drejtë dhe duhet të qëndrojë për arsye se vjen në harmoni me ndryshimet që u bënë në vitin 2018, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, ku është dhënë për herë të parë dhe definicioni për këtë subjekt⁶. Kjo shtesë nuk është pa qëllim sepse i referohet rasteve

⁴ Ekspertët e UNDP, A.Anastasi, A.Mandro, M.Semini.

⁵ Neni 55 I Konventës: “Neni 55 – Procedimet ex parte dhe ex officio I Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente nuk do të jenë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktimat e tërheq deklaraten ose ankesën e tij ose saj. 2 Palët marrin masa e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe/ose mbështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.”

⁶ Neni 3, pikal, gërma (ë) dhe pika 8

konkrete kur partnerë apo ish partnerë kanë kryer vrasje, pasi kanë ushtruar më parë dhunë psikologjike apo fizike tek viktimat dhe nuk janë marrë në përgjegjësi penale për dhunë në familje, se nuk ka patur parashikim të shprehur për këtë në Kodin Penal⁷.

Ky propozim është në përputhje me parashikimet e Konventës së Stambollit, neni 3 (b) dhe raporti shpjegues, paragrafet 41 dhe 42 përcaktojnë si dhunë në familje dhe veprat e dhunës të kryera nga personat në lidhje intime, me cilësinë e partnerit apo ish partnerit pavarësisht gjendjes së përbashkët të banimit me viktimën e dhunës. Neni 3/b i Konventës parashikon se:

“dhuna në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën;”

Relacioni shpjegues i Konventës së Stambollit, prg. 41 parashikon se:

Dhuna në familje përfshin dy lloj tipe dhune: dhuna e partnerëve intime, bashkëshort ose partner aktuale, ish bashkëshort ose ish partner...”

Relacioni shpjegues i Konventës së Stambollit, prg. 42, parashikon se:

Dhuna në familje si dhunë midis partnerëve intime përfshin dhunën fizike, seksuale, ...midis bashkëshortëve apo ish bashkëshortëve si dhe midis partnerëve dhe ish partnerëve.... Edhe pse termi “familjare (dhunë në familje)” duket sikur e limiton kontekstin e ku ushtrohet kjo dhunë, hartuesit pranojnë/njohin se dhuna shpesh vazhdon pasi një marrëdhënie ka mbaruar dhe bien dakort që nuk kërkohet si kusht banesa e përbashkët midis dhunuesit dhe viktimës.”⁸

d) Në lidhje me rritjen e masave të dënimit. Duke i respektuar mendimet dhe sugjerimet e ardhura në adresë të Komisionit për masat e dënimeve penale të propozuar në nismën ligjëvënëse, është e rëndësishme të theksojmë se qëllimi i saj është parandalimi i rasteve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore⁹. Analizat dhe studimet ligjore janë mëse të vlefshme, por fakti mbetet se rastet e ushtrimit të kësaj dhune nuk po ulen, por janë në rritje të vazhdueshme.

Debati se nuk e parandalon dhunën në familje rritja e dënimit, por edukimi i shoqërisë dhe forcimi i masave administrative dhe shërbimeve përkatëse, është korrekt, por në të njëjtën

⁷ Kujtojmë këtu dy vrasje të kryera në një hark kohor prej 6 muajsh, në gjysmën e parë të vitit 2018, të dy vajzave, nga ish partnerët e tyre (rasti Don Bosko dhe rasti Fakulteti i Mjekësisë).

⁸ Adresuar dhe rekomandimi i M.Drejtësisë për përputhshmërinë me parashikimet e Konventës së Stambollit, raporti i të cilës për Shqipërinë 2017 është dhe një prej arsyeve të kësaj nisme. Me këtë sqarim, marrin përgjigje dhe disa çështje të ngitura në opinionet e ardhura në Komision nga EURALIUS, etj, mbi cilësinë e partnerit intim në kuadër të dhunës në familje sipas parashikimeve të Konventës së Stambollit.

⁹ Në komentet e bëra për nismën kishte dhe sugjerime për të shtuar ose pyetje në lidhje me anën subjektive të veprës penale, plagosje e rëndë në paragrafin e tretë të nenit 130/a, çështje për të cilën nismëtarët, nuk kanë paraqitur ndonjë propozim për ndryshim në draftin e depozituar në Kuvend në Janar 2020.

kohë dhe subjektiv, pasi të gjitha mjetet ligjore kanë rëndësinë e tyre dhe duhet punuar njëkohësisht për forcimin apo zbatimin e të gjitha llojeve të masave.

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, ka një rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje nga 1.998 raste në vitin 2010 deri në 4.951 raste në vitin 2018. Gjatë tre viteve të fundit (2016- 2018), ka pasur një rritje të vazhdueshme me 9% çdo vit të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje.

Episodet e përsëritura të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore, veçanërisht rastet kur dhuna përsëritet edhe ndaj grave që kanë përfituar urdhër mbrojtje nga gjykata, deri në humbjen e jetës, janë këmbanë alarmi për ndërhyrje të menjëhershme në legjislacion me mekanizma që forcojnë masat kundër dhunës.

Sipas propozueseve mosreferimi i këtyre rasteve apo ulja e numrit të referimeve në organin e prokurorisë (tendenca e organeve të policisë për ta zgjidhur çështjen me urdhër mbrojtje, pra me masa administrative civile, apo tërheqja e viktimës), hetimi dhe gjykimi i dhunuesve në gjendje të lirë, dhe jo me masa të sigurimit personal (arrest me burg) ka ndikuar në përsëritjen e dhunës deri në vrasjen e viktimave të dhunës. Këtu duhet mbajtur parasysh se distancimi i dhunuesit nga viktimat është domosdoshmëri në rastet e dhunës në familje, siç rekomandon dhe GREVIO, me qëllim për të parandaluar përsëritjen e dhunës, dhe me dënimet aktuale që parashikon neni 130/a, ky qëllim nuk arrihet, parë kjo në këndvështim me parashikimet e K.Pr.Penale për kushtet dhe kriteret e masës së arrestit.

Propozimet e nismës u bazuan përveç sa më sipër, dhe në raportin GREVIO për Shqipërinë ku thuhet shprehimisht: *“Të dhënat e marra nga raporti i shtetit nuk i lidhin dënimet me veprat specifike që lidhen me to, andaj GREVIO nuk është në gjendje të dalë në konkluzione përfundimtare në këtë drejtim. Raporti tregon se nga 516 dhunues të dënuar në vitin 2014, shumica dërrmuese (492) janë ndëshkuar me burgim gjer në dy vjet. Po njësoj, gati të gjitha dënimet e dhëna në vitin 2015 (804 nga 821 gjithsej) kishin marrë dënime me burgim për të njëjtat kohëzgjatje. Vetëm tetë persona të dënuar në vitin 2014 dhe në vitin 2015 ishin dënuar me burgim deri në pesë vjet”*.

GREVIO fton autoritetet shqiptare:

166. Duke iu referuar propozimeve të tij mbi rrethanat lehtësuese, GREVIO nxit gjithashtu autoritetet të rishikojnë dispozitat e Kodit Penal Shqiptar për vrasjen në rrethana lehtësuese dhe dhunën fizike në rastet e dhunës në familje”.

Gjithsesi nisur nga mendimet e ardhura në Komision¹⁰, (Prokuroria e Përgjithshme, Unioni i Gjyqtarëve, Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare, pedagogë të Fakultetit të

¹⁰ Janë përcjellë në Komision mendime psh. që lidhen me nenin 84 të Kodit Penal “Kanosja”, ku i bëhet referim këtyre neni për të vlerësuar nëse janë të përshtatshme propozimet për dënimin me burg në paragrafin e dytë të nenit 130/a të Kodit Penal, të cilat nuk përputhen me konstatimet e GREVIO, që për këtë nen (84) shprehet: “...125 “Ndalimi i çdo kërcënimi të rëndë që mund të shkaktojë vdekjen ose lëndim të rëndë personal, sipas Nenit 84 të KPSH-së, është tepër i ngushtë për të kapur të gjitha format e kërcënimit që janë relevante për përcaktimin e dhënës në nenin 33 të Konventës. Për shembull, ai nuk përfshin shantazhin ose kërcënimet për të zbuluar sekrete personale. Në përgjithësi, Neni 84 i KPSH-së përjashton të gjitha kërcënimet e një intensiteti më të ulët, të cilat shpesh janë pjesë e modelit të abuzimit, veçanërisht në situatat e dhunës në familje”. Ndërsa për nenin 82 të K.Penal, që referohet në disa mendime. GREVIO

Drejtnësisë, etj) ku ndërsa në përgjithësi, qëllimi i nismës vlerësohet pozitiv (kryesisht shoqatat), por dënimet penale të propozuara nuk çmohen proporcionale, në konsultim me ekspertë të së drejtës penale, dhe kolegë të Komisionit, dënimet penale të propozuara në nismën e paraqitur riformulohen referuar studimit të veprave penale të ngjashme në Kodin Penal. Për pasojë, për parashikimet në paragrafin e parë të nenit 130/a dënimi propozohet të jetë “*deri në 3 vjet burgim*”, ndërsa për parashikimet në paragrafin e dytë të nenit 130/a dënimi propozohet të jetë “*deri në 4 vjet burgim*”.

Në lidhje me dënimet penale të propozuara për paragrafin e tretë dhe të katërt të nenit 130/a, nismëtarët dhe relatorja, duke marrë parasysh mendimet e sjella në Komision në kuadër të konsultimit të nismës dhe opinionet e kolegëve të Komisionit,¹¹ çmojnë se është e rëndësishme që në kuadër të hartimit të Kodit të ri Penal, të studiohen këto vepra¹² në mënyrë që të përcaktohen sanksione të sakta dhe efektive për të parandaluar rastet e dhunës në familje që sic është shpjeguar më sipër, po rriten dhe janë një shqetësim real në shoqërinë shqiptare¹³. Në këtë mënyrë, adresohet dhe shqetësimi i ngritur nga Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare. Gjithsesi duhet nënvizuar se koncepti që “*Dhuna psikologjike është sinonime me fyerjen, e cila në Kodin Penal dënohet vetëm me gjobë. Në marrëdhëniet familjare toleranca për fyerjen është më e lartë se sa në marrëdhëniet me persona të tretë, jashtë familjes, jo e kundërta*”, sic parashtrohet në mendimin përkatës¹⁴, nuk është në harmoni me konstatimet e GREVIO, që u morën për bazë në hartimin e kësaj nisme, që shprehimisht thotë: “*123. Abuzimi psikologjik konsiderohet si një formë mbizotëruese e dhunës në familje, e cila mund të perceptohet nga viktimat si më e rëndë dhe më e dëmshme se dhuna fizike*”.

Në lidhje me propozime të tjera të ngritura në komision në kuadër të konsultimit publik të nismës:

- a) Në lidhje me propozimin për të shtuar në subjektet e veprës penale dhe “*personin kujdestar*”, nismëtarët çmojnë se një parashikim i tillë është në Kodin Penal dhe konkretisht në nenin 124/b të tij. Në vlerësimin e relatores, parashikimet e nenin 124/b adresojnë vetëm mbrojtjen e fëmijës, por jo të personave të tjerë që mund të jenë në kujdestari. Në kushte të tilla u sugjerua që kjo çështje duhet të adresohet në të ardhmen.

shprehet: “*165. Përveç rrethanave lehtësuese të shqyrtuara më lart në këtë raport, KPSH-ja ka elemente të tjera të cilat parashikojnë dënime më të lehta. Këto përfshijnë, ndër të tjera, një formë e zbutur e vrasjes kur kryhet në një gjendje të shqetësimit të thellë psikiatrik të shkaktuar nga dhuna ose një fyerje serioze nga ana e viktimës dhe dispozita paralele që zbatohet për shkeljet e sulmit fizik të zbutur. Gjendja e tronditjes së thellë psikike mund ta zvogëlojë dënimin me më shumë se gjysmën. Duke qenë se nga dëshmitë ekzistuese, mbrojtja në bazë të provokimit shpesh ka pasur ndikim të ndryshëm duke diskriminuar gratë, GREVIO është i shqetësuar se kjo dispozitë ka potencialin të justifikojë vrasjen dhe dhunimet fizike në rastet e dhunës kundër grave, e në veçanti, në veprat penale që lidhen me dhunën në familje, si një kundërreagim legjitim ndaj vështirësive në marrëdhënie*”

¹¹ Pra dënimet në këto paragrafë të mbeten sic janë aktualisht në fuqi.

¹² Për shembull, nga 220 raste gjithsej të trajtuara nga Gjykata e Rrethit Tiranë, në vitin 2016, vetëm 17 raste janë ndjekur penalisht sipas pikës 2, nenit 130/a i KPSH-së, në lidhje me kanosjen. (Raport Grevio 2017, Footnote 124)

¹³ Grevio ka dhënë disa rekomandime dhe për nenet 121/a, 124/a, si dhe 82 dhe 84 të K.Penal, të cilat duhet të jenë padiskutim çështje për vendimmarrje gjatë hartimit të Kodit të ri Penal.

¹⁴ Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare, Opinion

- b) Në lidhje me kërkesën për përkufizimin e termave “*gjini e afërt*” dhe “*krushqie afërt*”, në kushtet kur arkitektura e Kodit të Familjes nuk ka të parashikuara definicione, u gjet me vend vend të referohemi në kodin e procedurës penale ku jepet përkufizimi I këtyre termave kur bëhet fjalë për papajtueshmërinë.
- c) Në lidhje me çështjet e tjera të ngritura që kërkojnë ndërhyrje në legjislacionin mbi masat e dhunës në marrëdhëniet familjare, ligjin “Për noterinë” apo Kodin civil, këto sugjerime do t’i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave dhe do të mbahen parasysh nga Komisioni gjatë shqyrtimit të nismave përkatëse.

Lidhur me riformulimet e neneve 242/1 dhe 242/2

Pas shqyrtimit në Komision, bazuar edhe në konsultimin publik të nismës, u sugjerua riformulimi për nenet e propozuara nga deputetja Edlira Bode.

Lidhur me konstatimin se nisma po shqyrtohet me procedurë të përsheptuar, në diskutimet në komision u vu në dukje se amendamentet i janë bashkëlidhur nismës së deputeteve Gjermani dhe Bushka, bazuar në nenin 71, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, i cili parashikon *se çdo deputet ka të drejtë të paraqesë amendamente gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës.*

Gjithashtu, ndonëse në kushtet e zhvillimit të punimeve online, procedura e konsultimit publik u krye e plotë dhe me pjesëmarrje të institucioneve dhe grupeve të interesit.

Çështje të parashtruara nga relatorja dhe për diskutim në komision lidhur me amendamentet e deputetes Edlira Bode, ishin si më poshtë:

Së pari, a mundet ligjvënësi të parashikojë dënime penale për shkelje që parashikohen nga ligje të posacme si shkelje administrative dhe për të cilat parashikohen dënime të rënda me gjobë? Nëse po, në cilat raste do të zbatohen masat administrative dhe në cilat raste dënimet penale.

Ky aspekt është analizuar me kujdes gjatë shqyrtimit të amendamenteve të deputetes Bode. Që në fillim të diskutimit të amendamenteve nga relatorja u vu në pah se në Kodin Penal ka një vakum ligjor lidhur me përhapjen e sëmundjeve infektive dhe epidemive nga viruset, ndonëse në Kodin Penal parashikohen vepra penale në lidhje me substanca të tjera, por jo për bakteret dhe viruset. Është përgjegjësi e ligjvënësit që prej vitit 1995 nuk ka parashikuar një vepër penale të posacme, ndërkohë që historia e së drejtës penale tregon se në legjislacionin shqiptar më parë ka ekzistuar një dispozitë e tillë dhe se në shumë legjislacione të vendeve të tjera evropiane ka rregullime të tilla.

Me kërkesë të relatores, shërbimi i kërkimeve parlamentare kreu një kërkim në lidhje me modelet e kodeve penale të vendeve të tjera. Sipas studimit kode penale të vendeve të ndryshme parashikojnë vepra penale për shkelje të ligjeve në lidhje me sëmundjet infektive ose epidemitë.

Sikurse është theksuar edhe më lart në raport, në lidhje me nevojën e pasjes së një

rregullimi penal janë shprehur edhe përfaqësuesit e institucioneve të përfshira në konsultim publik të nismës, konkretisht: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), Dhoma e Avokatëve Penalistë, Misioni EURALUS, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, deputetë të Komisionit për Cështjet Ligjore. Lidhur me parashikimin e zbatimit të dënimit penal, pasi më parë është zbatuar dënimi administrativ, ky argument qëndron dhe u vlerësua. Kjo nuk është përvoja e parë në legjislacionin shqiptar. Raste të tilla janë të shumta, për më tepër që në nenin 35 të ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive dhe ngjitëse” është sanksionuar se veprimet dhe mosveprimet e parashkura në në këtë nen si shkelje dënohen administrativisht, nëse nuk përbëjnë një vepër penale.

Riformulimi i nenit 241/1 të propozuar (*rinumërtuar 293/dh*) është i drejtë, pasi masat mbrojtëse të parashikuara në ligjin 15/2016 dhe në aktin normativ nr 2 që ndryshon masat e dënimit për shkeljet administrative, janë parandaluese për të siguruar sigurinë dhe shëndetin publik. Ndaj, krahas vijimit të zbatimit rigoroz të masave administrative të sipërcituara, dënimi penal zbatohet vetëm në rast të përsëritjes së veprimeve të paligjshme dhe pasi më parë është zbatuar një masë administrative sipas parashikimit të bërë në paragrafin 1 të nenit 241/1 (*rinumërtuar 293/dh*).

Së dyti, përcaktimi i seksionit të kreut VIII të Kodit Penal ku do të vendosen dispozitat e propozuara.

Një nga cështjet e diskutuara është se në cilin kre dhe seksion të Kodit Penal do të vendosen dispozitat e propozuara. Për këtë u vlerësuan dy elementë: qëllimi i propozimit dhe përmbajtja e tij.

Nga relacioni shoqëruar dhe analiza e përmbajtjes së propozimit del e qartë që e mira që mbrohet është siguria publike dhe shëndeti publik. Në raste epidemie dhe pandemie, institucionet kanë detyrimin që të marrin masa që të mbrojnë sigurinë publike dhe shëndetin publik. Sipas propozueses së amendamenteve dhe bazuar në analizën e përmbajtje së tyre, anëtarët e komisionit diskutuan për kreun ku duhet të përfshihen këto nene dhe nevojën e numërimit të tyre. Bazuar në faktin se qëllimi i propozueses është mbrojtja e sigurisë publike dhe shëndeti publik se siguria në periudhë të epidemive ose pandemive ose emergjencës shëndetësore sigurohet me akte, urdhra dhe vendime që miratohen nga institucione të përcaktuara nga ligji 15/2016, dhe se shkeljet e këtyre akteve cojnë në cënim të sigurisë publike dhe jo vetëm të individit u sugjerua që këto dy dispozita të përfshihen në kren VIII, seksioni III të Kodit Penal dhe të numërtohen 293/dh dhe 293/e. Gjithashtu, bazuar në sugjerimet e deputetit Xhafaj u bë riformulimi i emërimit të neneve të dispozitës 241/1 (293/dh) “Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë epidemisë ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore”

Sugjerimi i adresuar nga deputeti Beqja dhe MSHCS lidhur me terminologjinë e dispozitës dhe mbajtja parasysh e terminologjisë që përdor ligji 15/2016 dhe nevoja për diferencim të subjekteve është mbajtur parasysh në riformulim.

Së treti, vlerësimi i natyrës së ligjeve që adresohen në dispozitat e propozuara

Lidhur me sa shprehet Avokati i Popullit që në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme ose epidemive ka shumë organe që nxjerrin akte dhe publiku nuk i njeh ato, vlerësojmë se ligji 15/2016 dhe ai “Për emergjencat civile” parashikon në mënyrë shteruese organet kompetente që nxjerrin akte, urdhëra dhe udhëzime dhe detyrimin e njoftimit të publikut nga organet kompetente dhe media. Nga ana tjetër, padijenja e ligjit nuk është argument për mosdënimin penal, me përjashtim të rasteve të mirëpërcaktuara në Kodin Penal.

Së katërti, subjekti i veprës penale: personi që mbart sëmundjen apo kushdo që nuk respekton rregullat.

Kjo çështje u diskutua gjerësisht me propozuesen gjatë shqyrtimit në komision, si dhe gjatë konsultimit publik nga disa institucione që e kanë adresuar këtë çështje.

Bazuar në parimet e dënimit, konkretisht individualizimi i dënimit dhe objektiviteti, gjatë riformulimit u qartësua se ka përgjegjësi penale:

- a) subjekti i cili nuk është mbartës i infeksionit, por shkel kufizimet e përcaktuara në rregullat, vendimet dhe urdhrat e organeve publike, pasi është dhënë më parë masë administrative;
- b) subjekti i cili nga autoriteti kompetent është udhëruar të qëndrojë në izolim ose karantinë dhe shkel legjislacionin parandalues në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore ose epidemisë.

Nevoja për riformulim dhe saktësim është adresuar nga relatorja, KMD, Shoqata e Avokatëve Penalistë, Avokati i Popullit, etj. Sugjerimet janë gjetur të drejta dhe janë marrë në konsideratë dhe reflektohen në riformulimin që i është bërë neneve përkatëse të depozituara.

Së pesti, parashikimi i formave të fajësisë: dashje apo neglizhencë, apo të dyja?

Në disa opinione të paraqitura gjatë konsultimit publik dhe deputetë të Komisionit për Çështjet Ligjore kanë shprehur mendimin se ka nevojë për një raport të drejtë midis rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallës së fajit të autorit.

Ky sugjerim u vlerësua duke bërë një ndarje ndërmjet subjektit që ka detyrimin të zbatojë rregullat e vendosura nga organet kompetente në rast të fatkeqësive natyrore dhe epidemive, por që nuk janë të deklaruar si mbartës të sëmundjeve infektive, por potencialisht mund ta kenë atë dhe rrezikojnë të tretët dhe atyre që janë udhëruar nga organet kompetente me ligj të qëndrojnë në izolim, në karantinë pasi kanë kontakte të ngushta me personat mbartës ose të vetë karantinohen.

Ky diferencim i bërë në riformulim mundësoi që masat e dënimit të caktohen në proporcion me shkallën e fajësisë së subjektit, i cili konsumon veprën penale dhe pasojat që kanë ardhur si rrjedhojë e shkeljes së marrëdhënies juridike të mbrojtur nga legjislacioni penal. Në këtë mënyrë sugjerimet e bëra gjatë konsultimit publik janë mbajtur parasysh në riformulimin e përmbajtjes së dispozitave.

Së gjashti, proporcionaliteti i dënimit bazuar në pasojat, anën objektive, përsëritjen

dhe anën subjektive të kryerjes së veprës penale.

Bazuar në konsultimin publik dhe diskutimet në Komision, u bë një përshkallëzim dhe harmonizim i dënimeve bazuar të shkalla e rrezikshmërisë së veprës pasojave dhe për rrjedhojë të cilësimit të veprimeve krim ose kundërvajtje penale si dhe të dënimeve penale.

Gjatë diskutimit të propozimeve të relatores u morën në shqyrtim propozimet e deputetes Elena Xhina e cila sugjeroi riformulim të paragrafit të parë të nenit 293/dh për të bërë dallimin me mirë me paragrafin e dytë të këtij neni. Gjithashtu, deputeti Alket Hyseni sugjeroi një ndryshim të masës së dënimit në paragrafin e dytë të nenit 293/dh dhe një riformulim nga pikëpamja e teknikës legislative të nenit 293/e.

VIII VLERËSIMI I NISMAVE NGA KËNDVËSHTRIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Nismat e deputeteve Gjermani dhe Bushka dhe amendamentet e deputetes Bode u analizuan në raport me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë shqyrtimit në Komisionin për Çështjet Ligjore nismat u vlerësuan nga dy këndvështrime: së pari, respektimi i proporcionalitetit të dënimit penal me rrezikshmërinë e veprës penale dhe me shkallën e fajit të autorit; së dyti, respektimi i parimit të mos zbatimit të dy dënimeve kryesore penale.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj në lidhje me proporcionalitetin e një kufizimi thekson se *“Gjykata e vlerëson rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte si balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori”*¹⁵.

Në vendimin nr. 9, datë 26.02.2019 të Gjykatës Kushtetuese, kjo Gjykatë ka theksuar se legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme, të tilla si pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. Ai bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit . Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit, nga ana tjetër.¹⁶

Gjykata çmon se edhe në çështjen në shqyrtim, balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis

¹⁵ Vendimi nr. 47/2012 I Gjykatës Kushtetuese, pika 31, faqe faqe 10.

¹⁶ Vendimi nr. 9, datë 26.02.2019 i Gjykatës Kushtetuese, pika 17, faqe 6.

së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër.¹⁷

Bazuar në këtë jurisprudencë, masat e dënimit në nismën e propozuar dhe në amendamentet e shqyrtuara u ripanë dhe janë përshkallëzuar në varësi të faktit nëse personi ka kryer një shkelje më parë, rrezikshmëria e veprës si në rastin kur personi thyen izolimin ose karantinën e urdhëruar nga organi kompetent, pasoja e ardhur siç është rasti i përhapjes me dashje të sëmundjeve infektive me rrezikshmëri të lartë dhe që kanë sjellë pasoja të rënda për jetën ose vdekjen e një ose më shumë personave.

Në dhënien e një masë dënimi, është vlerësuar diskrecioni që ka gjykata që është organi që vlerëson të gjitha rrethanat dhe elementët e tjerë të veprës penale.

Në vlerësimin e dënimit penal me burgim dhe të kufijve minimal dhe maksimal të tij, nismat u vlerësuan nisur nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e cila thekson se ndryshimet që ndërmerr ligjvënësi duhet t'i nënshtrohen më parë studimeve të thelluara për të shmangur prishjen e balancave edhe në raport me veprat e tjera penale, në varësi të rrezikshmërisë shoqërore të tyre¹⁸.

Gjatë shqyrtimit të propozimeve në Komision u vlerësuan masat e dënimit për përhapjet me dashje të sëmundjeve infektive me rrezikshmëri të lartë shoqërore kur kanë sjellë pasoja të rënda për shëndetin me atë nivel dënimi që është parashikuar për plagosjen e rëndë me dashje dhe në rastin kur nga vepra penale ka ardhur vdekja e një ose më shumë personave, dënimi penal nga 5-15 vjet burgim është në ato nivele që Kodi Penal parashikon për vepra penale të tjera.

Propozimet ligjore të deputetes Bode parashikojnë dënime me efekt të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve infektive me rrezikshmëri të lartë.

Përsa i përket moszbatimit të dy dënimeve kryesore penale, amendamentet e deputetes Bode u diskutuan nën jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht me vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese është shprehur se parashikimi në dispozitat e Kodit Penal të dy dënimeve kryesore bie në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17 i Kushtetutës.

Sa më sipër, në riformulimin e dispozitës është mbajtur parasysh jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

IX PËRFUNDIME

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

¹⁷ Shih vendimet nr.12, datë 14.04.2010; nr.47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Po aty, pika 47, faqe 14.

Në **aspektin ligjor**, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në **aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, e miratoi me ndryshimet sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti dhe ia përcjell atë seancës plenare.

RELATORE

VASILIKA HYSI

KRYETAR

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____/2020

**"PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995,
"KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetesh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 130/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 130/a

Dhuna në familje

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e

njerka), ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim.”

Neni 2

Pas nenit 293/d shtohen nenet 293/dh dhe 293/e me përmbajtjet si më poshtë:

“Neni 293/dh

Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë epidemisë ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore

Moszbatimi ose kryerja e veprimeve në kundërshtim me urdhërat, vendimet e nxjerra nga organet shtetërore gjatë epidemisë ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të ndryshme nga ato të parashikuara në paragrafin e dytë të këtij neni, kur është dhënë më parë masë administrative, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Moszbatimi i urdhrat të dhënë nga organet kompetente për karantinim, vetëkarantinim ose izolim, apo shkelja e rregullave të karantinës, vetëkarantinës ose izolimit nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.

Neni 293/e

Përhapja e sëmundjeve infektive

Moszbatimi apo kryerja e veprimeve në kundërshtim me urdhrat apo vendimet e organeve shtetërore që kanë të bëjnë me parandalimin apo luftimin e sëmundjeve infektive, kur ka shkaktuar përhapjen e sëmundjes infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin te njerëzit, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Kur kjo vepër, ka shkaktuar vdekjen e një ose më shumë personave, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

